

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tjetër goditje për Brad Pitt, vajza 21-vjeçare e aktorit të famshëm merr vendimin e papritur ndaj tij
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/29/tjeter-goditje-per-brad-pitt-vajza-21-vjecare-e-aktori-t-te-famshem-merr-vendimin-e-papritur-ndaj-tij/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 12:30:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	29 shtator 2026, 12:24:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 29 shtator 2026, 12:23:00 UTC → 29 shtator 2026, 12:25:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a058ae7edf4da6802e750e9a54a6fcdf50c283420ad23f60631134c1264738ca
TEKSTI	93442ffe95edffa2afff0ebdef83befb40dc0f0b18b844f86709b460f3e9cb8b
PAMJA	5c8bb2c6649e79a44534ba3b9989938bd124b4a13d5a1950a1667884772ed23d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0ab34128708797d5c2d7ca4c5b91bba2dafc586c0ea1aa542ddc486f80345f17
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5a00511fec2dd72c79527889eef91c0b757bfc2cb84c819aee6ec0978e94e200
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0ab34128708797d5c2d7ca4c5b91bba2dafc586c0ea1aa542ddc486f80345f17>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Tjetër goditje për Brad Pitt, vajza 21-vjeçare e aktorit të famshëm merr vendimin e papritur ndaj tij

29/09/2026 14:24



Zahara Marley Jolie-Pitt, vajza e Brad Pitt dhe Angelina Jolie, tashmë zyrtarisht mban vetëm mbiemrin e nënës. Gjykata në Kaliforni ka miratuar kërkesën e 21-vjeçares për të hequr "Pitt" nga emri i saj.

Pas vendimit të së hënës, 28 shtator, ajo tashmë njihet ligjërisht si Zahara Marley Jolie, duke u bërë fëmija i tretë i çiftit që ndërmerr këtë hap.

Brad Pitt, 62 vjeç, dhe Angelina Jolie, 51 vjeç, kanë gjashtë fëmijë: Maddox, Pax, Zahara, Shiloh dhe binjakët Vivienne e Knox. Çifti u nda në vitin 2016, ndërsa divorci u finalizua në dhjetor 2024.

Zahara kishte dorëzuar kërkesën për ndryshimin e emrit në qershor. Vetëm pak ditë më herët, edhe vëllai i saj Maddox kishte nisur procedurën për të hequr mbiemrin "Pitt". Në shtator, emri i tij u ndryshua zyrtarisht nga Maddox Chivan Jolie-Pitt në Maddox Chivan Jolie.

Ata ndjekin kështu motrën e tyre Shiloh, e cila kishte kërkuar heqjen e mbiemrit të babait në vitin 2024, sapo mbushi 18 vjeç.

Ndërkohë, edhe Vivienne ka nisur procedurën për të kaluar nga "Vivienne Marcheline Jolie-Pitt" në "Vivienne Marcheline Jolie". Seanca e saj gjyqësore është caktuar për 2 nëntor.

Një histori familjare që vazhdon të tronditë Hollywood-in

Ndryshimet e emrave vijnë në një periudhë kur marrëdhëniet mes Brad Pitt dhe disa prej fëmijëve të tij janë raportuar si të tensionuara.

Sipas burimeve të cituara nga "PEOPLE", komunikimi mes aktorit dhe fëmijëve të tij të rritur është aktualisht shumë i kufizuar. Një burim pranë Pitt ka pretenduar se situata është rezultat i një procesi të gjatë largimi të fëmijëve nga babai, ndërsa pretendime të tilla janë pjesë e një historie të kontestuar familjare.

Në vitin 2016, Pitt u hetua pas një incidenti të pretenduar gjatë një udhëtimi me avion privat, ku u ngritën akuza për sjellje abuzive ndaj një prej fëmijëve.

FBI më vonë e mbylli hetimin pa ngritur akuza ndaj aktorit, ndërsa autoritetet e Los Angeles-it përfunduan hetimin e tyre pa gjetje për abuzim.

Zahara, megjithatë, kishte dhënë më herët sinjale se dëshironte të identifikohet vetëm si Zahara Marley Jolie. Në ceremoninë e diplomimit nga Spelman College në Atlanta, në maj, ajo u prezantua me këtë emër.

POP NEWS • TË FUNDIT



Gati 1 milion euro nga sendet personale të Brigitte Bardot, ankandi tejkalon vlerësimet fillestare



Sezoni i ri i "Për'puthen" vjen me rregulla strikte, Heidi Baci: Konkurrentët dhe opinionistët janë të detyruar të...



Vdekja e djalit të Cindy Crawford, klinika e rehabilitimit prej 7.7 milionë dollarësh ku ai iu nënshtrua trajtimit para vdekjes së tij



"Mashkulli që kërkon grua të virgjër...", Rita Petro: Të bësh seks me dritë ndezur duhet të jesh shumë mendje hapur

ME TË LEXUARAT

Dikur e quanin vajza më e shëmtuar e shkollës, sot është një nga modelet më të famshme

Pas 12 vitesh pritje, Rita Ora më në fund merr patentën, e tregon me krenari në "Instagram"


'Më pëlqen të jem një i huaj në Hollywood', Aktori Casey Affleck: Nuk preferoj të jem pjesë e rrethit të ngushtë

FOTO/ Nga veshjet elegante tek ato më të puvimshme viet në shkëlqimin

Me vendimin e fundit të gjykatës, Zahara bëhet fëmija i tretë i Brad Pitt dhe Angelina Jolie që zyrtarisht heq mbiemrin "Pitt".

Top Channel

I Pop News »



Pas 12 vitesh pritje, Rita Ora më në fund merr patentën, e tregon me krenari në "Instagram"

29/09 12:12



FOTO/ Nga veshjet elegante tek ato më të guximshme, yjet që shkëlqyen në Javën e Modës në Paris

29/09 11:15



'Më pëlqen të jem një i huaj në Hollywood', Aktori Casey Affleck: Nuk preferoj të jem pjesë e rrethit të ngushtë

28/09 22:09



Dikur e quanin vajza më e shëmtuar e shkollës, sot është një nga modelet më të famshme

28/09 21:12



Vajza më e vogël e Steven Spielberg martohet, fustani romantik i nusërisë dhe puthja e çiftit në perëndim të diellit

28/09 20:02



Pësoi djegie të rëndë me ujë të valuar pak para koncertit, Nicole Scherzinger nuk e anuloi performancën

28/09 19:33

në Javën e Modës në Paris

Tjetër goditje për Brad Pitt, vajza 21-vjeçare e aktorit të famshëm merr vendimin e papritur ndaj tij

Pësoi djegie të rëndë me ujë të valuar pak para koncertit, Nicole Scherzinger nuk e anuloi performancën

Ku ishte Kopshti i Edenit? Harta e shekullit të 16-të 'tregon' vendndodhjen e mundshme të Parajsës Biblike

Vajza më e vogël e Steven Spielberg martohet, fustani romantik i nusërisë dhe puthja e çiftit në perëndim të diellit

"U bëra bulimik", Sylvester Stallone rrëfen betejën me fizikun: Përdora steroide për "Rocky III"

A do të lidhej me ndonjë banor brenda shtëpisë së "Big Brother VIP"? Amber: Më mirë t'i nxjerr vetë të palarat...


Na ndiqni:



I Video »



Top News – Irani: Trump, ky gënjeshtar i madh! 'Nëse ne nuk shesim naftë, askush tjetër nuk mundet'



Top News- 'Qeveria të mos zvarrisë ligjin për DHSK/ PDK: Kurti, përgjegjësi për presidentin



Top Channel/ Keni kontakt me Kos/? Rama i përgjigjes gazetares në Bruksel: Kemi kontakt, por...



Top News – Mashtrimi në emër të Taulant Ballës/Të rinjtë fajësojnë njëri-tjetrin, por të dy gënjejnë



Top Channel/ "Shume mire që protestojnë", Rama nga Brukseli për protestën: Jam angazhuar e kam folur



Top Channel/ "Pse ti nuk më pëlqen?", Rama batutë me gazetaren në Bruksel: Jo, më thuaj, nuk më pëlqen

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet

Top Channel

Rreth Top Channel
Kontakt
Bileta – Portokalli
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.